



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

**DEPARTAMENTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DECENTRALIZIM DHE
KOMUNITETE**

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raporti Mujor –Maj 2007

Sistemi aktual i transportimit të paraburgosurve rezulton në vonesa të panevojshme të cilat zgjatin kohën e paraburgimit dhe mund të shkelin të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme

Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete (DDNjDK) pranë OSBE-së Misionit në Kosovë është i shqetësuar për sistemin aktual të transportimit të paraburgosurve nga Njësitë Qendrore të Prishtinës për Transportimin e të Burgosurve (NjQPTB) i cili shkakton vonesa të panevojshme të procedurës penale dhe në mënyrë të panevojshme zgjat kohën e qëndrimit të paraburgosurve në paraburgim. Kjo gjithashtu mund të kontribuoj në shkeljen e të drejtës së gjykitimit brenda një kohe të arsyeshme.

Shërbimi përcjellës/transportues i të paraburgosurve në Kosovë për momentin është i bazuar në Procedurën Standarde të Veprimit të aprovuar nga Departamenti për Rendin Publik me datë 11 Mars 2005¹. Kjo procedurë përcakton NjQPTB e cila është në zinxhirin komandues të Departamentit të Drejtësisë (DD) si organ i vetëm kompetent për përcjelljen e të paraburgosurve nga qendrat e paraburgimit nëpër gjykata dhe anasjelltas.²

Ligji vendor kërkon që autoritetet gjyqësore të zhvillojnë procedurat pa vonesë.³ Për më tepër, kur një i pandehur është duke u mbajtur në paraburgim, kohëzgjatja e paraburgimit duhet “zvogëluar në kohën sa më të shkurtë të mundshme”⁴ dhe që “të gjitha agjencitë pjesëmarrëse në procedurë penale [...] të veprojnë me urgjencë të veçantë.”⁵ Në mënyrë të ngjashme, standardet ndërkombëtare kërkojnë që kur një i pandehur mbahet nën arrest, koncepti i “një kohe të arsyeshme” me të cilin secili ka të drejtë të gjykohe⁶ duhet të interpretohet nën një standard më rigoroz.⁷

Pavarësisht nga këto kërkesa ligjore, OSBE ka monitoruar disa raste në të cilat dështimi nga ana e NjQPTB për të ofruar transportimin e të paraburgosurve shpiti në shtyrjen e seancave. Kjo ka shkakton vonesa të panevojshme të procedurave gjyqësore.

¹ Direktiva si e ndryshuar në 2006, rregullon për Gjykatat që kërkojnë asistencë policore në përcjelljen e të paraburgosurve për seanca gjyqësore, duhet të kontaktojnë Njësitin e Planifikimit (NjP) jo më vonë se 72 orë para seancës së caktuar. Pasi që NjP nuk ofron “siguri statike,” SHPK është përgjegjëse për sigurimin e të paraburgosurve përgjatë seancave. Sipas informatave që OSBE ka në dispozicion, direktiva nuk është implementuar për më tepër se dy vite: autoritetet relevante filluan të aplikojnë procedurën e kërkuar pas një përkujtimi me shkrim të dërguar nga Drejtori i Operacioneve me 21 Mars 2007.

² Për shembull NjP, i cili është i vendosur në Prishtinë, është përgjegjës për transportimin e të paraburgosurve nga qendra e paraburgimit në Prizren për në Gjykatën e Qarkut në Prizren, edhe pse distanca mes dy institucioneve është afërsisht 50 metra larg nga njëra tjetra. SMSJ është në dijeni të situatave ku të paraburgosurit për shkak të mungesës së transportit mbrapa në qendrat e paraburgimit, janë lënë me orë të tëra në zyrat e Prokurorëve. Në një rast një i paraburgosur është dashur të kalojë natën në Stacionin e SHPK-së, dhe gardianët lokalë është dashur ti blejnë ushqim nga gjepi i tyre.

³ Neni 5(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale (“KPPPK”).

⁴ Neni 5(3), PKKKP

⁵ Neni 279(2), PKKKP

⁶ Neni 14(3)(c) KNDCP dhe neni 6(1), KEDNj

⁷ Shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), *Abdoella v. Holandës*, 12728/87, Nëntor 1992, paragrafi 24.

Në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në (...) në gjykimin e (...) të pandehurve për (...) ⁸, gjykata shtyu seancën e datës (...), sepse NjQPTB dështoi të sjellë të akuzuarit në kohë nga qendra e paraburgimit në (...). Kryetari i trupit gjykues theksoi se vonesat e shkaktuara nga problemet e transportimit të paraburgosurve kanë ndodhur edhe më parë në të njëjtin rast.

Në një rast hetimi pranë Prokurorisë Publike të Qarkut në (...) kundër (...) të pandehurve për veprën penale të (...), ⁹ (...) të pandehur janë ftuar për tu marrë në pyetje me datë (...). Edhe pse prokurori u kishte dërguar me kohë autoriteteve të qendrës së paraburgimit në (...), kërkesën për transportimin e të paraburgosurve ¹⁰, NjQPTB nuk kishte sjellë të pandehurit në seancën hetimore. Rrjedhimisht gjykata e shtyu seancën.

Në një rast të rigjykit të (...) të pandehurve të akuzuar për (...) sipas kodit të mëparshëm penal ¹¹ pranë Gjykatës së Qarkut në (...), gjykata shtyu seancën e datës (...), sepse NjQPTB dështoi të sjellë të akuzuarit nga qendra e paraburgimit të (...) në gjykatë.

Në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në (...) në gjykimin e (...) të pandehuri të akuzuar për (...) vepra penale të (...), ¹² kryetari i trupit gjykues njoftoi se seanca e parë e caktuar me datë (...), do të shtyhet për një muaj pasi që NjQPTB nuk mundi të sjellë të pandehurin nga qendra e paraburgimit në (...). ¹³

Në rastet e përmendura më sipër, dështimi i sistemit aktual të transportimit dhe përcjelljes për të siguruar prezencën e të paraburgosurve para autoriteteve gjyqësore ka rezultuar në vonesa në procedurat gjyqësore. Kjo në mënyrë ta panevojshme ka zgjatur kohën e të paraburgosurve në paraburgim, dhe përfundimisht mund të kontribuoj në shkeljen e të drejtës së të pandehurve për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme. ¹⁴

Në kuptim të sipërpërmendurës, OSBE rekomandon që:

Policia e UNMIK-ut dhe DD të ndryshojë sistemin aktual të centralizuar të përcjelljes/transportimit të paraburgosurve nga ana e NjQPTB, ashtu që të sigurojnë që të paraburgosurit të transportohen me kohë për pjesëmarrje në procedurat gjyqësore.

⁸ Neni (...) Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK).

⁹ Neni (...), KPPK.

¹⁰ Prokurori dërgoi kërkesën me (...).

¹¹ Neni (...)LPK dhe (...) LPP.

¹² Neni (...), KPPK.

¹³ Lënda përmbante urdhrin e gjykatës për transportimin e të paraburgosurit nga Burgu i Qarkut në (...).

¹⁴ Si edhe GjEDNj që thekson "Shtetet janë të obliguara të organizojnë sistemet e tyre të drejtësisë për të mundësuar gjykatave ti përmbahen kërkesave nga Neni 6(1)" i Konventës, përfshirë këtu edhe gjykimin brenda një afati të arsyeshëm (*krahaso Muti v. Italisë*, 14146/88, 23 Mars 1994, paragrafi 15)

Arsyetimi jo adekuat i aktgjytimeve në kontestet civile bën shkelje të ligjit vendor dhe mund të ndikojë në të drejtën e palës për një gjykim të drejt

OSBE është e shqetësuar sepse arsyetimet e pamjaftueshme të aktgjytimeve në kontestet civile shkelin ligjin vendor dhe mund të ndikojnë në të drejtën e palëve në kontest civil për një gjykim të drejtë.

Edhe pse nuk kërkohet shprehimisht sipas Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) njeh kërkesën e një vendimi të arsyetuar në të dy rastet ato civile dhe penale nënkuptohet në të drejtën e përgjithshme për një gjykim korrekt.¹⁵ Një vendim i arsyetuar mirë është veçanërisht i rëndësishëm për ti mundësuar palës që të ushtroj të drejtën e ankesës. Ankuesi nuk mund të sfidoj në mënyrë adekuate vendimin e gjykatës më të ulët pa pasur njohuri mbi arsytet themelore për aktgjykimin e disfavorshëm.¹⁶ Duke iu përmbajtur obligimeve ndërkombëtarisht të pranuarra për një aktgjykim të arsyetuar mirë, Ligji mbi Procedurën Kontestimore (LPK) thekson që një aktgjykim i plotfuqishëm duhet të përmbaj shpjegimin duke përfshirë edhe faktet dhe argumentet në të cilat është bazuar.¹⁷ Në mënyrë më të veçantë, LPK kërkon nga gjykatësit që në arsyetimin e tyre të përshijnë edhe rezultatet e procedurës së provave, të gjitha faktet së bashku dhe një nga një, si dhe të vlerësojnë të gjitha faktet në të cilat është bazuar vendimi.¹⁸ Gjykata gjithashtu do të veçojë dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi.¹⁹ Mungesa e arsytimit të një aktgjykimi përbën shkelje substanciale të ligjit procedural dhe shërben si bazë për ankesë.²⁰

Për kundër këtyre dispozitave ligjore vendore dhe ndërkombëtare, OSBE ka monitoruar disa raste ku aktgjykimet në konteste civile nuk janë arsyetuar në mënyrë adekuate.

Në një kontest civil pronësor në Gjykatën Komunale në (...) për vërtetimin e pronësisë, gjykata mori aktgjykimin me datë (...) duke aprovuar padinë e paditësit. Aktgjykimi vetëm numëronte provat e dorëzuara trupit gjykues gjatë procedurës dhe nuk ka vlerësuar faktet e rastit. Gjykatësi po ashtu kishte harruar bazën ligjore në të cilën e kishte bazuar aktgjykimin.

Në një rast tjetër në Gjykatën Komunale në (...) në një kontest mes (...) personave për të drejtën e shfrytëzimit të një (...) pronë e komunës së (...) gjykata e shkallës së parë vendosi në favor të njërit prej personave dhe vendosi të dëboj personin tjetër nga (...). Megjithatë komuna kërkoj nga gjykata ankimore që të ndaloj dëbimin sepse nuk pajtohej me vlerësimin e gjykatës. Me (...), gjykata ankimore ndaloi ekzekutimin e aktgjykimit. Por vendimi mbi ankesë vetëm përsëriti deklaratat e palëve, dhe nuk përmblodhi apo vlerësoi provat e ofruara, dhe nuk dha ndonjë arsyetim ligjorë. Aktgjykimi vetëm

¹⁵ Shih GjEDNj, *Hadjianastassiou v Greqisë*, 12945/87, 16 Dhjetorë 1992, paragrafi 33 dhe *Hiro Balani v. Spanjës*, 18064/91, 09 Dhjetor 1994 paragrafi 27.

¹⁶ Shih *Suominen v. Finlandës*, 37801/97, 24 Korrik 2003, paragrafi 34-38.

¹⁷ Neni 338(1) LPK.

¹⁸ Shih Komentin mbi LPK nga Tomislav Ralçiç dhe Vitoje Tanaskoviç, 1980, faqet 552-553.

¹⁹ Neni 338(4) LPK.

²⁰ Neni 354(2) pika 13 LPK.

përmendi të drejtën në pronësi,²¹ por nuk citoj ligjin vendor të aplikueshëm apo ti aplikoi në faktet e rastit.

Në këto raste, arsyetimi jo adekuat nga ana e gjyqtarëve shkel ligjin vendorë dhe atë ndërkombëtarë. Kjo gjithashtu vështirësoi mundësinë e palës që të ushtroj të drejtën në ankesë.

Rrjedhimisht, OSBE rekomandon që gjykatësit:

- Të marrin aktgjykime të arsyetuara me referencë të veçantë në ligjin relevant dhe faktet e rastit.
- Të vlerësojnë sigurinë dhe të bazojnë aktgjykimet në provat e dorëzuara gjatë procedurës.
- Në ankesë dhe siç parashihet me ligj, ose të ndryshojnë aktgjykimin ose të kthejnë lëndën për rigjykim, në rast se, aktgjykimi i shkallës së parë nuk ka arsyetim adekuat apo lë jashtë fakte kyçe, dështon në citimin e ligjit relevant apo nuk e aplikon ligjin në fakte.

²¹ Gjyqtari bazoi aktgjykimin në Nenin (...) të Protokollit (...) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) e cila e parasheh të drejtën të pronësi.